



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Pritiljeno / Prodato Received / Delivery	18-05-2022	2	viii god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAPUSACK	2897/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.420/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1464/2020 i datës 26.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.183/2020 e datës 07.07.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr. 183/2020 me numër protokoli 1321/2020 e datës 07.07.2020 e parashtruar nga ankuesi

II. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Podujevës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke kthyer ankuesin në pozitën "Zyrtar i Lartë i Personelit" sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2013.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s h e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në pozitën "Zyrtar i Lartë i Personelit" në komunën e Podujevës, me Vendimin me Nr. 02-104/02-0024890/20 të datës

03.06.2020 të Nënkryetarit të Komunës është transferuar përkohësisht në pozitën “Zyrtar i Lartë në Shërbimin e Gjendjes Civile” në kuadër të Drejtorisë së Administratës në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj. Ankuesi më datë 08.06.2020 i është drejtuar Nënkryetarit të Komunës lidhur me transferimin e përkohshëm me ç’rast ka refuzuar transferimin e përkohshëm dhe ka kërkuar që të rishqyrtohet vendimi i datës 06.02.2020 dhe të tërhiqet i njëjti. Ndërsa më datë 10.06.2020 Nënkryetari i Komunës e ka njoftuar ankuesin se komunikimi përmes njoftimit nuk mund të merret parasysh dhe të shqyrtohet nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Ankuesi më datë 15.06.2020 i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të komunës Podujevës kundër transferimit të përkohshëm, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Refuzon ankesën e ankuesit me arsyetimin se vendimi për transferim është i përkohshëm.

Ankuesi brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 03.06.2022 për transferim të përkohshëm dhe vendimit të datës 22.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të komunës Podujevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 08.07.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek komuna e Podujevës, ndërsa Këshilli me datë 20.07.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.08.2020 përmes Njoftimit me numër protokolli 1581/20, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.183/2020 të datës 07.07.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, dhe ka udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datë 19.04.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1464/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 19.08.2020 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.183/2020 të datës 07.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1321/2020 të datës 07.07.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim nga Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.1464/2020 i datës 19.04.2022; Thirrje për shqyrtimin kryesor i datës 22.03.2022; Padi e datës 04.09.2020; Fletëkthesë e datës 25.08.2020; Fletëkthesë e datës 21.07.2020; Njoftim i datës 19.08.2020; Akt Emërim i B.N. i datës 01.03.2013; Vendim me Nr.02-104/02-0024890/20 për transferim të përkohshëm i datës 03.06.2020; Njoftim i datës 08.06.2020; Përgjigje lidhur me njoftimin nga Nënkryetari i Komunës së Podujevës i datës 10.06.2020; Ankesë nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të komunës Podujevës e datës 15.06.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe

Ankesave të komunës Podujevës me Nr.13-104/02-0028062/20 i datës 22.06.2020; Letërnjoftimi i B.N.; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 08.07.2020; Përgjigje në ankesë e datës 20.07.2020; Kërkesë për transferimin e nëpunësit civil me Nr.13-112/02-0023658/20 i datës 27.05.2020; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 28.05.2020; Përgjigje rreth kërkesës për transferim të nëpunësit civil me Nr.13-110/05-23764/20 i datës 28.05.2020; Pliko me nr. R9075094 e datës 16.07.2020; E-mail nga B.N. për C.Z. i datës 05.05.2022; E-mail nga C.Z. për B.N. i datës 05.05.2022; E-mail nga F.B. për C.Z. i datës 06.05.2022; E-mail nga C.Z. për F.B. i datës 05.05.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit kundër vendimit të datës 03.06.2022 për transferim të përkohshëm dhe vendimit të datës 22.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të komunës Podujevës i cili kërkon që të anulohen vendimet e lartcekura dhe të kthehet në vendin paraprak të punës sipas akt emërimit të datës 01.02.2013 në pozitën "Zyrtar i Lartë i Personelit" në komunën e Podujevës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, ka gjetur që Nënkyetari i Komunës së Podujevës me Vendimin me Nr. 02-104/02-0024890/20 të datës 03.06.2020 ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita "Zyrtar i Lartë i Personelit" në pozitën "Zyrtar i Lartë në Shërbimin e Gjendjes Civile" në kuadër të Drejtorisë së Administratës në komunën e Podujevës, ndërsa në pikën II të të njëjtit vendim është paraparë që *"Transferimi i të përmendurit bëhet për shkak të nevojave dhe vëllimit të punëve në kuadër të Shërbimit të Gjendjes Civile, dhe atë në kohëzgjatje dymbëdhjetë (12) muaj"*, si rrjedhojë duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Transferimi i përkohshëm mund të zgjatë deri në dymbëdhjetë (12) muaj"*, ndërsa në bazë të përgjigjes së institucionit nga menaxheri i personelit përmes e-mailit të datës 06.05.2022 dhe në bazë të përgjigjes nga pala përmes e-mailit të datës 05.05.2022, konstaton që ankuesi ende vazhdon të jetë i angazhuar në pozitën ku është transferuar sipas Vendimit për transferim të përkohshëm me Nr. 02-104/02-0024890/20 të datës 03.06.2020 nga Nënkyetari i Komunës së Podujevës, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pas kalimit të periudhës së transferimit të përkohshëm prej dymbëdhjetë muaj ankuesi nuk është kthyer në pozitën e tij të cilën e mban me Akt Emërim dhe mbi bazë të kësaj nuk mund të vazhdohet periudha e transferimit pasi që transferimi i përkohshëm nuk mund të jetë më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj dhe pas kalimit të periudhës së transferimit të përkohshëm në bazë të Vendimit me Nr. 02-104/02-0024890/20 të datës 03.06.2020 ankuesi duhet të kthehet në vendin e tij të punës sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2013, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 5 paragrafit 3 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *"Pas kalimit të periudhës së transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën paraprake"*, andaj pretendimi ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm dhe i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Kryetari i Komunës së Podujevës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, janë të obliguar që ankuesin ta kthejnë në

vendin e tij të punës të cilin e ka mbajtur me akt emërim të datës 01.02.2013 në pozitën "Zyrtar i Lart i Personelit" në komunën e Podujevës.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.420/2022.**

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës
- Znj. Gjqqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Arkivit të KPMSHCK-së

